

STATUT DHE AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“INTERNATIONAL PROTECTION SERVICE” SHPK

Tirane, sot me date **03.06.2022**, (dymije e njezet e dy), nën cilësinë e ortakut themelues të shoqërisë:

Z. GIUSEPPE SEBASTIANO REALE, shtetas italian, atesia Francesco dhe mëmësia Oriana, i datelindjes 16.07.1968, lindur ne Novi Ligure (AL), Itali, banues ne Itali, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit nr. 763548 dhe nr, identifikimi CA18402BF lëshuar nga Ministria e Brendshme Italiane me datë 08.05.2018 dhe vlefshmeri deri me 16.07.2028.

i cili me cilesine e ortakut themelues redaktoi aktin e themelimit, nepermjet te cilit ai deklaroi se me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare“, ne ligjin “Per QKB“, ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, “INTERNATIONAL PROTECTION SERVICE” SHPK.

KREU I

Neni 1 **Emertimi**

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“INTERNATIONAL PROTECTION SERVICE” SHPK.**

Neni 2 **Forma Juridike**

Shoqeria **“INTERNATIONAL PROTECTION SERVICE” SHPK**, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”), e themeluar nga personat fizikë te siperpermendur, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe nuk mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë vetem deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raporti.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne: rr. “ Qemal Stafa”, pallati 13, shkalla nr.5 njesia bashkiake nr.2 Tirane .

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti i aktiviteti

Objekti i aktivitetit te Shoqerise eshte:

- Krijimi i siteve ne internet - E-Commerce - Platforma - CRM - CMS - dizajnimi dhe krijimi i aplikacioneve, ANDROID APP - IOS APP - SEM - SEO NE SITE - SEO OFF-SITE - SEA - marketing ne media sociale.
- Identiteti i markes, strategjia dixhitale
- Reklammat ne Facebook dhe Google - automatizimi i marketingut
- Zhvillimi dhe auditimi i kontratave inteligjente
- Zhvillimi i Blockchain
- Zhvillimi i inteligjencës artificiale
- Siguria e IT-së.
- Shërbime konsulence për individë, konsulencë dhe biznes
- Konsulencë për organet publike
- Konsulencë për organet private dhe shtetërore dhe strategjitë zhvillimore lidhur me objektin e sipërpërmendur
- Konsulencë për sigurinë pasive dhe dixhitale për alarmet dhe kamerat e ambienteve

Neni 5

Kohezgjatja

SHOQERIA DO TE ZHVILLOJE AKTIVITETIN E SAJ PER NJE PERIUDHE KOHORE TE PAPERCAKTUAR.

KREU II

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte percaktuar ne shumen **100,000 leke** (nje qind mijë leke) dhe eshte i perbere nga 1 kuote. Vlera e nje kuote eshte **100,000 leke**.

Z.**GIUSEPPE SEBASTIANO REALE**, eshte zoterues i 100% te kuotave te kapitalit, me vlere te pergjithshme 100,000 leke, qe perbejne 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

KREU III
ADMINISTRIMI I SHOQERISE
Neni 7
Administrimi i shoqërisë

Shoqëria administrohet nga një administrator që zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë 5 vjeçare. Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë, përveç atyre që ligji ky Akt Themelimi dhe Statuti ja rezervon Asamblese së përgjithshme apo organeve të tjera të shoqërisë,

Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve, akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e shoqërisë. Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të shoqërisë. Në rast konflikti të interesit, administratori do të njoftojë menjëherë ortaket si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

Administratore e shoqërisë do të jetë Znj. Rezarta Duka, shtetëe shqiptare, me zotësi të plote juridike, lindur në Krujë, mbajtëse e kartës së identitetit nr. J15410017H e cila do të ushtrojë funksionet në këto detyra për 5 (pese) vjet, me të drejtë ri emërimi nga data 04/06/2022 deri në datën 03/06/2027.

NENI 8

BILANCI VJETOR DHE DIVIDENDI

Viti Financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik.

Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabel të Autorizuar (nese janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblese së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si dhe llogaritë vjetore.

Pasi të jenë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Ligji “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Shoqëria me vendim të Asamblese së Përgjithshme vendos shpërndarjen e dividendit në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakeve.

NENI 9

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Ne rastin e prishjes dhe likujdimit te shoqerise do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin per “Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”.

;

Neni 10
Ligji i zbatueshem

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqipetar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Krijimin e Shoqerive Tregtare” , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri .

Neni 11
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata e rrethit Gjyqesor te Tiranes.

Neni 12
Dispozita perfundimtare

Akti I themelimit u perpilua ne 4 kopje, ne guhen shqipe dhe italiane per t'ju shperndare organeve kompetente dhe 2 kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise “INTERNATIONAL PROTECTION SERVICE “. Akti I themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortakët.

ORTAK I VETEM

Z. GIUSEPPE SEBASTIANO REALE